



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 799/4 Prot.

Durrës, më 22.4.2024

VENDIM

Nr. 25, datë 22.4.2024

**"PËR MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI NË STATUTIN E UNIVERSITETIT
"ALEKSANDËR MOISIU" Durrës"**

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" përkatësisht neni 49, të ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", të Statutit të UAMD-së, të Rregullores së UAMD-së, të Urdhërit nr. 101, datë 13.03.2024 të Ministrisë të Arsimit dhe Sportit "Për procesin zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet e arsimit të lartë", të vendimit të Senatit Akademik nr.29 datë 29.03.2024 për miratimin e Rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës", vendimit të Senatit Akademik nr.35, datë 15.04.2024, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Miratimin e një ndryshimi në Statutin e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës përkatësisht në nenin 14 pika 7, si rrjedhojë ndryshimin në përbërjen e Senatit Akademik të ardhshëm si më poshtë:

"Senati akademik përbëhet nga 25 anëtarë. Të gjithë fakultetet e Universitetit janë përfaqësuar në Senatin Akademik. Senati Akademik përbëhet nga: Rektori i Universitetit, i cili është dhe Kryetari i Senatit, Rektori që mbaron mandatet, në rastet kur nuk kandidon automatikisht për mandatin në vijim është anëtar si pjesë e listës së njësisë kryesore që i përket, 4 (katër) përfaqësues të personelit mësimor shkencor të secilit Fakultet të UAMD si dhe 3 (tre) përfaqësues të studentëve".

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi:

- Administratori

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Ada ALIAJ

